



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:154022

Datë: 10.05.2024

Numri i dokumentit: 05669217

P. 2022:154023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Dega në Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, dhe bashkëpunëtori profesional Ismail Kuçi, në çështjen penale kundër të pandehurit R.S, i shpallur fajtor për veprën penale Mashtrimi nga neni 323 paragrafi 5 të KPRK–së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr. 1002/2022 të datës 27.07.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 29.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, të pandehurit R.S, dhe mbrojtësi i të pandehurit i caktuar sipas detyrës zyrtare - Avokat Q. B, më datë 30.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 10.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: R.S, nga, Ferizaj, Rr.”...”, i lindur me datë ... nga i ati R... dhe e ëma H... e gjinisë S..., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, prind i 1 vajze, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 18.05.2022, në rrugën “Ismail Raka”, saktësisht në kafiterinë “ART-Caffe”, në Kaçanik, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve ka mashtruar qytetarët, ashtu që para qytetarëve ka prezantuar dokumentet mjekësore në emër të M. P duke kërkuar para kinse për shërimin e tij dhe ka arritur të mbledh shumën e parave në vlerë 42.60 (katërdhjetë e dy euro e 60 cent).

-Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 323 paragrafi 5 të KPRK-së,

Andaj duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumë 200€ (Dyqind euro), të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në 4 këste të barabarta në afat prej 4 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet, me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të pa paguara, nëse kësti nuk paguhet me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

II.1 Konfiskohen në mënyrë të përhershme shumën e parave në vlerë 42.60 (katërdhjetë e dy euro e 60 cent).

II.2. Paratë e konfiskuara, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi i kalohen buxhetit të shtetit.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 50.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, ka ngritur aktakuzën Ferizaj PP/II.nr. 1002/2022 të datës 27.07.2022, kundër të pandehurit R.S, i ër veprën penale Mashtrimi nga neni 323 paragrafi 5 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj aktakuze, si dhe konform nenit 240 të KPPK-së, caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 29.04.2024

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka deklaruar së është penduar për veprimet e kryera, dhe i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris vepra penale në të ardhmen.

Mbrojtësi i të pandehurit – Avokat Q. B. ka deklaruar se i mbrojturi i tij ka qenë i njoftuar paraprakisht lidhur me pasojat dhe benefite e pranimit të fajësisë, këtë pranim e ka bërë me vullnet të lirë dhe me bindje të plotë, ka kërkuar nga gjykata të njejtit ti pranohet fajësia pasi që është bër konform dispozitave ligjore të nenin 242 të KPPK-së. Me rastin e caktimit të dënimit po ashtu ka kërkuar nga gjykata që të ketë përsyshe edhe rrethanat lehtësuese të paraparë me neni 70 par.3 të KPRK-së, siq janë: pranimi i fajit duke marre përsyshtë pasojat dhe benifitet të sajë, pendimin për veprimet e bëra dhe premtimi se nuk do të përsëris veprime qe janë në kundërshtim me ligjin, kryerja e veprës penale të natyrës së tillë për të paren herë, i njeti është mbajtës i familjes dhe kujdeset për fëmijët e vetëm pasi qe tani është i shkurorëzuar, po ashtu i mbrojtur im nuk gëzon shëndet të plotë ,ai nga problemet shëndetësore përdore edhe mbajtëse apo shkopinjte nga dëmtimet në këmbë, për veq këtyre i mbrojturi im është edh i pa punë dhe jeton në kushte të vështira. Andaj shqiptimi i një sanksioni më të butë apo më të lehtë dot e kishte arritur edhe qëllimin e dënimit.

Prokurori i Shtetit ka shprehur pikëpamjet lidhur me pranimin e fajësisë, ka theksuar se pasi qe i pandehuri e ka pranuar fajësinë ky pranimi i fajësisë mbështetët në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe është bërë konfrom nenit 242 të KPPK-së. E

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe pikëpamjet e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 par 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit plotësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 paragrafi 5 të KPRK-së në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se: i njëjti e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, është penduar për veprimet që ka bërë, premtimin se nuk do të përsëris vepra penale në të ardhmen, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata gjeti se i pandehuri është recidivist, e cila vërtetohet nga certifikata mbi dënimet penale e lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale e datës 29.04.2024, i njëjti është dënuar me vendim të formës së prerë në lëndët P.nr.281/2016 i datës 04.05.2017, P.nr.555/2018 i datës 20.11.2019, P.3086/2017 i datës 20.12.2019 dhe P.nr.2134/2017 i datës 20.01.2020.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Vendimi për konfiskimin

Konform nenit 269 paragrafi të KPPP-së, shumën e parave në vlerë 42.60 (katërdhjetë e dy euro e 60 cent), janë konfiskuar në mënyrë të përhershme, pasi që të njëjtat përbëjnë pasuri, e cila është fituar me kryerjen e veprës penale mashtrimi, për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2023:154023, më datë 10.05.2024

Gjyqtari:
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.